



Pranuar / Dorezuar Primiteno/Prizato Received / Delivery	15. 03	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOPJESHICK	1378/2022		114	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 126/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi - anëtarë me Rushit Kajtazi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.945/2019 të datës 03.02.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 30/2019 të datës 21.01.2019 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokatit [redacted] me adresë [redacted]

[redacted] kundër organi të punësimit Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.03.2022, mori këtë

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.30/2019 e datës 21.01.2019, e parashtruar nga ankuesi [redacted] nga Lipjani.

### A r s y e t i m

Agjencia e Statistikave të Kosovës, më datë 28.09.2018 ka shpall konkursin e jashtëm për pozitën "Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo me rastin e publikimit të njoftimit për kandidatin e suksesshëm i njëjti nuk është përzgjedhur dhe me datë 04.12.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën e lartcekur më datë 10.10.2018, ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të mbikëqyrë procedurën e rekrutimit. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka mbikëqyrë procedurën



e rekrutimit për pozitën e lartcekur dhe pas përfundimit të procedurës dhe përgatitjes së raportit nga Anëtari i Këshillit për Mbikëqyrje, në mbledhjen e njëzet e pestë (XXV) të mbajtur më datë 05.12.2018 ka nxjerr Vendimin Nr.383/2018 me të cilin ka Aprovuar si të rregullt procedurën e rekrutimit për pozitën "Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare".

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me vendimin e datës 21.12.2018, nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, më datë 21.01.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 324/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 23.01.2019, me numër protokolli 413/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa me datën 28.01.2019 me numër protokolli 497/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.03.2019 përmes shkresës me numër protokolli 1629/2019, ka njoftuar përfaqësuesin e autorizuar të ankuesin, se nuk mundë të shqyrtoj ankesën A.nr. 30/2019 të datës 21.01.2019, për shkak së ne mungese të anëtarëve nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me njoftimin e datës 28.03.2019 të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 03.02.2022, përmes Aktgjykimit A.nr.945/2019, ka anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, dhe ka obliguar Këshillin që të vendos lidhur me ankesën A.nr.30/2019 të datës 21.01.2019, të parashtruar nga ankuesi [redacted]

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 21.01.2019 me numër protokolli 30/2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi Nr.945/2019, i datës 03.02.2019, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi i datës 05.12.2018, i Këshillit; Kërkesë për qasje në dokumente; Vendimi i datës 21.12.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesë e datës 04.12.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Konkursi; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë; dëshmi nga trusti; Renditja përfundimtare e kandidateve; Përmbledhja e vlerësimeve Individuale; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm; Vlerësim Individual i Kandidateve për Vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të Huaj; Testi me shkrim; Raporti i Rekomandimit; Raporti Final i Rekomandimit; Autorizimi i datës 26.09.2018, i Ministrisë së Administratës Publike; Vendimi i datës 15.10.2018, për themelimin e Komisionit përzgjedhës; Lista e ngushtë; Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; Regjistrimi i Aplikacioneve të Pranuar; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës





02.04.2007; Akt emërimi i datës 02.10.2015; Kontrata e marrëdhënies se punës; Akt emërimi i datës 04.04.2012; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitur; Diplomë e datës 14.12.1982; Akt emërimi i datës 10.01.2013; Kontrata e marrëdhënies se punës e datës 06.05.2009; Vërtetim i datës 17.09.2018; Reference e datës 16.05.2008; Vërtetim i datës 11.11.2002 dëshmi nga trusti; kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; dëshmi nga trusti; Kërkesa për punësim e Shpresa Kastrati, me shkresat e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Vërtetim i datës 04.07.2017; vërtetim i datës 07.09.2016; Njoftimi i datës 03.09.2019, i Këshillit; Përgjigje ne ankesë e datës 28.01.2019, me numër protokolli 497/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, [redacted] është e palejuar, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, ka mbikëqyrë procedurën e rekrutimit lidhur me rekrutimin e pozitës "Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare" në të cilën konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Rrjedhimisht pas përfundimit të procedurës se rekrutimit, Anëtari i Këshillit i cili ka qene i ngarkuar për mbikëqyrjen e zhvillimit te procedurës, ka dorëzuar raportin me shkrim dhe në mbledhjen e njëzet e pestë (XXV), të mbajtur më datë 05.12.2018 Këshilli ka nxjerr Vendimin me Nr.369/2018 me të cilin ka aprovuar si të rregullt këtë procedurë te rekrutimit me arsyetimin se procedurat e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar si me lartë ka konstatuar se Vendimi Nr.369/2018 i datës 05.12.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në funksionin e mbikëqyrjes se zhvillimit të procedurave të nivelit drejtues në Shërbimin Civil ka qenë vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë pasur të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ në pajtim me dispozitat e nenit 19 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke marr parasysh se në lidhje me ligjshmërinë e procedurës se rekrutimit për pozitën "Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare" të zhvilluar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Këshilli përmes Vendimit Nr.369/2018 të datës 05.12.2018, me shumicë të votave ka vendosur se procedura është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se ankesa e ankuesit e datës 21.01.2019 është e palejueshme sepse lidhur me këtë çështje ka vendosur Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.nr.126/2022**

Rushit KAJFAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit; [REDACTED]
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së